



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0200

Paneli Shqyrtues, i emëruar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani panelist individual duke vendosur sipas ankesës së OE “Helius System” Sh.P.K, kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe përkrahja e sistemit e-pasuria” me numër të prokurimit 214-25-11241-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme, më 29/04/2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Helius System” Sh.P.K me nr. 2026/0200, e datës 01/04/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe përkrahja e sistemit e-pasuria”, me numër të prokurimit 214-25-11241-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme.
2. Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, - Ministria e Punëve të Brendshme, datës 11.03.2026, për anulimin e aktivitetit prokurimit “Mirëmbajtja dhe përkrahja e sistemit e-pasuria”, me numër të prokurimit 214-25-11241-2-1-1.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Bazuar në nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues OE “Helius System” Sh.P.K i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të tarifës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.12.2025 Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja dhe përkrahja e sistemit e-pasuria”, me numër të prokurimit 214-25-11241-2-1-1. Ndërsa me datë 19.03.2026, AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00 €.

Me 24.03.2026, OE “Helius System” Sh.P.K ka parashtuar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 26.03.2026 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 01.04.2026, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Helius System” Sh.P.K me nr. 200/2026 lidhur me aktivitetin e cituar si në pikën I të dispozitivit me numër protokolli 0200/2026.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtuar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

1. Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim:

Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP, pas pranimit të Kërkesës për rishqyrtim e ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Autoriteti Kontraktues kishte iniciuar procedurën e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe përkrahja e sistemit e-pasuria" me nr. të Prokurimit: 214-25-11241-2-1-1. Ne lidhje me pretendimin 1 dreri ne 4 te OE ankues ZPP konstaton se me rastin e inicimit te procedurës se prokurimit nga njësia Kërkuese është dorëzuar Deklarata e fondeve dhe Disponueshmeris se mjeteve, mirëpo para përfundimit te vlerësimit te këtij aktivitet ka ndodhur rrethana te cilat nuk kane mundur te parashikohen me rastin e inicimit te procedurës, ne rastin konkret buxheti i planifikuar është bartur ne një njësi organizative tjetër, andaj edhe konfirmimi i mjeteve për herën e dyte siç parashohin rregullat e prokurimit nuk ka qene i mundur. Pas inicimit të kësaj procedure, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 02/ 02 te datës 20.02.2026 për riorganizimin institucional, është bërë ndarja e ministrisë, ku si rezultat janë krijuar struktura të reja institucionale. Si pasojë e këtij riorganizimi institucional është bërë edhe ndarja e buxhetit përkatës ndërmjet institucioneve të reja. Për shkak të këtij ndryshimi, Autoriteti Kontraktues aktualisht nuk disponon mjetet e nevojshme buxhetore për realizimin e kësaj procedure të prokurimit, pasi buxheti i planifikuar për këtë aktivitet është ndarë sipas strukturës së re institucionale dhe ne mungesë te mjeteve buxhetore AK-MPB nuk mund te beje ri konfirmimi që informatat financiare nuk kanë ndryshuar substancialisht nga ato te parapara ne fillimin e procedurës, siç parashihet ne rregullat ivën ligjore te prokurimit. Po

ashtu edhe njësisia kërkuese si inicuese e këtij aktiviteti ka kaluar ne Ministrin e Digjitalizimit dhe Administratës Publike, andaj Ministria e Punëve të Brendshme si autoritet iniciues fillestar, përveç qe nuk ka mjete buxhetore, po ashtu nuk ka nevojë për këto shërbime te parapara ne këtë aktivitet te prokurimit (Nëse Ministrin e Digjitalizimit dhe Administratës Publike e cila e ka buxhetin për këtë projekt ka nevojë për shërbime te tilla do ta tenderoi te njëtin aktivitet). Duke u bazuar në këto rrethana te krijuara Autoriteti Kontraktues ka anuluar procedurën e prokurimit. Sa i përket letrave standarde për eliminim ju informojmë se AK-JMPB pavarësisht anulimit te procedurës se prokurimit për arsyet e dhëna me larte, AK ka dashur te ju njoftoi se nuk keni plotësuar kërkesat e AK-se sipas kërkesave ne dosjen e tenderit dhe se këto informacione do te ju shërbenin apo te i keni parasysh ne rast se Ministrin e Digjitalizimit dhe Administratës Publike e cila e ka buxhetin për këtë projekt do ta tenderoi te njëtin aktivitet).

2. Pretendimet ankimore të “Helius System” Sh.P.K në ankesën 0200/2026

Pretendimet Ankimore 2.A, 2.B dhe 2.C

Aktiviteti i Prokurimit	Nr. 214-25-11241-2-1-1 — <u>Mirëmbajtja dhe përkrahja e sistemit e-pasuria</u>
Autoriteti Kontraktues	<u>Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)</u>
OE Ankues	2026/0200 HELIUS SYSTEMS <u>Sh.p.k Tiranë, Shqipëri</u>
Pretendimi	2.A — <u>Zhvilluesi 1 (XH.L)</u> 2.B — <u>Zhvilluesi 2 (M.C)</u> 2.C — <u>Analist Sistemi (G.J.M)</u>
Data e hartimit	09.04.2026

Pretendimi ankimor 2.A — Zhvilluesi 1: z. Xhelal Likaj (XH.L)

OE ankues lidhur me këtë çështje pretendon se sa i përket skualifikimit të Zhvilluesit 1, z. Xhelal Likaj (XH.L), Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, duke pretenduar se z. Likaj plotëson kriterin e 5 viteve përvojë në zhvillim softueri në platformën .NET me SQL Server, duke u bazuar në periudhën nga viti 2017 deri në momentin aktual, si dhe duke paraqitur tre projekte konkrete të ngjashme dhe certifikime të vlefshme Microsoft.

Pretendimi ankimor 2.B — Zhvilluesi 2: z. Marin Çollaku (M.C)

OE ankues lidhur me këtë çështje pretendon se sa i përket skualifikimit të Zhvilluesit 2, z. Marin Çollaku (M.C), Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, duke e eliminuar atë me arsyetimin se diploma e tij në “Informatikë Ekonomike” nuk plotëson kriterin e DT-së për “Baçelor i Shkencave Kompjuterike ose Baçelor Inxhinierisë Kompjuterike”, dhe duke mos marrë parasysh përvojën mbi 7-vjeçare të dokumentueshme në zhvillim softueri me .NET dhe SQL Server, të konfirmuara me projekte konkrete kombëtare dhe financiare.

Pretendimi ankimor 2.C — Analist Sistemi: z. Gjergji Mulla (G.J.M)

OE ankues lidhur me këtë çështje pretendon se sa i përket skualifikimit të Analistit të Sistemit, z. Gjergji Mulla (G.J.M), Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, duke argumentuar se z. Mulla zotëron mbi 25 vite përvojë në IT, ka ushtruar funksione tipike

të analistit të sistemit — si analizë kërkesash, projektim arkitekturash funksionale dhe teknike — dhe ka marrë pjesë si Project Manager dhe System Analyst njëkohësisht në projekte konkrete kombëtare të zhvilluara në platformën Microsoft, të konfirmuara me letër reference të datës 23.01.2026.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 02.04.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin e jashtëm teknik për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0200/2026, ndërsa me datë 14.04.2026 është dorëzuar raporti i ekspertizës me rekomandimet si në vijim: *Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues-teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-se.*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

3. Lidhur me pretendimet e OE “Helius System” Sh.P.K ekspertet shqyrtues dhe teknik përmes raportit nr. 0200/2026 kanë vlerësuar si në vijim:

Eksperti teknik, pas administrimit të dokumentacionit lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues kundër kritereve profesionale (9.1 dhe 9.2) të vendosura në DT, mendon:

- **Konstatimi i ekspertit për pretendimin ankimor 2.A**

Kërkesa e Dosjes së Tenderit (DT)

Eksperti teknik sqaron se lidhur me kriteret profesionale në DT për pozicionin Zhvillues i Softuerit (3 zyrtarë) dhe Zhvillues i Bazave të të Dhënave (2 zyrtarë), është kërkuar:

– Diplomë Universitare si Baçelor i shkencave kompjuterike ose Baçelor inxhinierisë kompjuterike;

– Minimum 5 vite përvojë pune në zhvillimin e softuerit (programim), të se paku tre projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën .NET me SQL Server;

– Dëshmi e kërkuar: Diplomë Universitare përkatëse (kopje), Kontratë pune valide (kopje), Letër reference (kopje), CV-në që dëshmon përvojën e punës.

Eksperti teknik, duke analizuar kërkesat e DT dhe dokumentacionin e ofruar nga OE ankues në dosjen e tenderit, thekson se:

Lidhur me Diplomën

OE ankues ka paraqitur: (i) Diplomë Bachelor në Informatikë Ekonomike, Universiteti i Tiranës / Fakulteti i Ekonomisë, 2014–2017; dhe (ii) Master of Science in Computer Science, / Fakulteti i Informatikës, 2018–2020. MSc in Computer Science tejkalon qartësisht kërkesën minimale të DT-së për diplomë — kriteri i diplomës plotësohet.

Lidhur me Përvojën 5-vjeçare në .NET + SQL Server

<u>Periudha</u>	<u>Roli / Punëdhënësi</u>	<u>Përvojë .NET+SQL?</u>	<u>Vërejtje</u>
07/2017 – 07/2018	Software Developer @ Heliu Systems, Tiranë	Po	C#, Visual Studio, MS SQL Server, Crystal Reports. E vetmja periudhë .NET+SQL e konfirmuar. ~12 muaj.
07/2018 – 10/2019	E papëc aktuar në CV	Jo	Asnjë pozicion pune i evidentuar. Përkon me studime Master (2018–2020).

10/2019 – 09/2020	Teaching Assistant @ CISPA Helmholtz Institute, Gjermani	Jo	Asistencë akademike në lëndë kibernetike. Jo zhvillim softueri.
10/2020 – aktualisht	Senior SOC Analyst @ Volkswagen Financial Services AG, Gjermani	Jo	SIEM, forensikë, threat hunting, cloud security. Rol ekskluzivisht kibernetik — asnjë .NET/SQL.
03/2024 – aktualisht	Cybersecurity Consultant (Part-Time) @ Heliu Systems	Jo	Konsulencë kibernetike, kohë të pjesëshme. Jo zhvillim softueri.

Duke analizuar CV-në Europass të paraqitur, eksperti teknik konstaton kronologjinë e mëposhtme të karrierës:

Nga analiza e mësipërme rezulton se përvojë e verifikueshme e z. Likaj në .NET + SQL Server është ~12 muaj (07/2017–07/2018), ndërsa kërkesa minimale e DT-së është 5 vite. Mungesa: ~4 vite.

OE ankues argumenton se “përvojë fillon nga viti 2017 duke vijuar pandërprerë”. Eksperti teknik konstaton se ky argumentim nuk qëndron, pasi Neni 69 LPP kërkon vlerësimin e aftësisë teknike në bazë të përmbushjes reale të përvojës në fushën specifike të kërkuar, jo thjesht vjetërsinë kronologjike të punësimit. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton qartë se nga viti 2019 e tutje, z. Likaj ka ushtruar funksione ekskluzivisht në fushën e sigurisë kibernetike, pa dokumentuar asnjë angazhim paralel apo të mëvonshëm në zhvillim softueri me .NET+SQL Server.

Lidhur me Letrën e Referencës (23.01.2026)

Letra e referencës e lëshuar nga Heliu Systems e titullon z. Likaj si “Senior Software Developer”, por përmbajtja e saj e përshkruan atë si zhvillues frontend (React, Vue, TypeScript, aksesueshmëri, UI/UX). Projektet e listuara — e-Albania 2.0 (dizajn dhe implementim frontend, React/TypeScript), Eterna Suite – Posta Shqiptare (punë frontend, kod i pastër) dhe Sistemi i Notereve NISA (rifaktorizim kod i UX, “teknologjitë e platformës Microsoft”) — nuk konfirmojnë operacione specifike backend në .NET ose SQL Server pas vitit 2018. Referimi ndëj “platformës Microsoft” është term i gjerë dhe i papërcaktuar që nuk plotëson standardin e verifikimit të kërkuar nga DT. Kjo krijon mospërputhje të brendshme në dokumentacionin e OE vetë: titulli i letrës sugjeron zhvillim softueri, por përmbajtja e konfirmon rolin si zhvillues frontend, Megjithëqë atë e gjithë përvoja në kuadër të Letrës së Referencës duket se përshin vetëm periudhën një (1) vjeçare.

Lidhur me Certifikimet Microsoft

<u>Certifikimi</u>	<u>Nr. Certifikatës</u>	<u>Data</u>	<u>Statusi</u>
MCSD: App Builder	G494-7798	05.12.2017	Fituar 2017 — i skaduar
MCSA: Web Applications	G422-2195	21.11.2017	Fituar 2017 — i skaduar

Microsoft Certified Professional (MCP)	G417-4786	14.11.2017	Fituar 2017 — i skaduar
Exam 761: Querying Data with Transact-SQL	Transcript ID: 15053792	31.01.2018	Fituar 2018 — i skaduar

Certifikimet e paraqitura janë autentike dhe të verifikueshme (Microsoft Certification ID: 15053792). Megjithatë, të gjitha janë fituar gjatë periudhës nëntor 2017 – janar 2018, njëkohësisht me punën e vetme si Software Developer @ Helius Systems. Asnjë certifikim i ri lidhur me platformën .NET nuk është i pranishëm pas vitit 2018, periudhë gjatë së cilës karriera e z. Likaj ka ndryshuar plotësisht drejt sigurisë kibernetike. Certifikimet dëshmojnë kompetencë teknike të asaj periudhe, por nuk zëvendësojnë kërkesën e DT-së për 5 vite përvojë pune të vazhdueshme sipas Nenit 69 LPP.

Konkluzion: Prandaj, bazuar në sqarimet e dhëna më sipër, ekspertit teknik mendon se pretendimi ankimor i OE ankues kundër vendimit të AK lidhur me shkualifikimin e Zhvilluesit 1 z. Xhelal Likaj ËSHTË I PABAZUAR.

• Konstatimi i ekspertit për pretendimin ankimor 2.B

Kërkesa e Dosjes së Tenderit (DT)

Eksperti teknik sqaron se lidhur me kriteret profesionale në DT për pozicionin **Zhvillues i Softuerit (3 zyrtarë) dhe Zhvillues i Bazave të të Dhënave (2 zyrtarë)**, është kërkuar:

- Diplomë Universitare si Baçelor i shkencave kompjuterike ose Baçelor inxhinierisë kompjuterike;
- Minimum 5 vite përvojë pune në zhvillimin e softuerit (programim), të se paku tre projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën .NET me SQL Server;
- Dëshmi e kërkuar: Diplomë (kopje), Kontratë pune valide (kopje), Letrër reference (kopje), CV

Eksperti teknik, duke analizuar kërkesat e DT dhe dokumentacionin e ofruar nga OE ankues në dosjen e tenderit, thekson se:

Lidhur me Diplomën — Analiza Teknike e Programit Akademik

OE ankues ka paraqitur Diplomë **Bachelor në Informatikë Ekonomike**, lëshuar nga Universiteti i Tiranës / **Fakulteti i Ekonomisë**, 2014–2017, dhe Diplomë **Master i Shkencave në Sisteme Informacioni në Ekonomi**, po nga Fakulteti i Ekonomisë, 2017–2019.

Eksperti teknik konstaton se kriteri i DT-së kërkon formim të thellë teknik në shkenca kompjuterike ose inxhinieri kompjuterike. Në kontekstin e universiteteve kosovare dhe rajonale, programet e klasifikuara si “Baçelor i Shkencave Kompjuterike” ose “Baçelor i Inxhinierisë Kompjuterike” — si Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike (UP/FIEK), Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri (UBT) dhe Shkenca Kompjuterike — Inxhinieri Softuerësh (AAB) — ndërtojnë tërë kurrikulën rreth disiplinave teknike kompjuterike: algoritëm i avancuar, arkitekturë sistemesh dhe softuerësh, inxhinieri softueri, bazat e të dhënave si modul i dedikuar e i thelluar, matematikë diskrete dhe logjikë formale, rrjeta dhe protokolle, siguri kompjuterike. Lëndët jo-teknike në këto programe janë minimale dhe kanë karakter plotësues. (<https://aab-edu.net/fakultetet/shkenca-kompjuterike/programet-studimore/shkenca-kompjuterikebsc/>, qasja: 09.04.2026; <https://www.ubt-uni.net/en/study/bachelor-programs/computer-science-and-engineering/>, qasja: 09.04.2026; <https://fiek.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,45,qasja: 09.04.2026>)

Programi “Informatikë Ekonomike” i Universitetit të Tiranës ka strukturë dhe orientim thellësisht të ndryshëm. Sipas syllabusit zyrtar të publikuar nga Fakulteti i Ekonomisë, UT (<https://feut.edu.al/26-rreth-nesh/dekani>, qasja: 09.04.2026), programi tre-vjeçar (180 ECTS total) ndërtohet mbi dy shtylla të barabarta: shtyllën e informatikës dhe shtyllën e ekonomisë. Shtyllën e parë e formojnë lëndët si Algoritmikë, Programim në C++, Programim në Java, Strukturë të Dhënash, Teori e Bazave të të Dhënave, Programim në Web dhe Arkitekturë Kompjuteri — lëndë me karakter teknik por të strukturuar si formim bazik e jo si specializim i thelluar. Shtyllën e dytë — dhe më të madhen në kreditë totale — e formojnë Marketing, Menaxhim, Mikroekonomi, Makroekonomi, Kontabilitet Financiar dhe Ekonometri, të cilat nuk kanë lidhje me formimin teknik të zhvilluesit të softuerit. Krahas këtyre dy shtyllave, programi përfshin edhe Matematikë të Zbatuar dhe Statistikë të orientuara drejt analizës ekonomike — disiplina të ndryshme substancialisht nga matematikë diskrete, logjika formale që ndërtojnë bazën algoritmike në programet e dedikuara të shkencave kompjuterike.

Eksperti teknik vëren se nga 180 kredite totale të programit, lëndët me karakter teknik kompjuterik zënë rreth 46 kredite ECTS — gjegjësisht rreth sa zë **një vit i plotë akademik** nga tre vitet e programit. Kreditë e mbetura shpërndahen midis lëndëve ekonomike, matematikës ekonomike, gjuhëve të huaja, lëndëve plotësuese dhe tezës së diplomës. Kjo strukturë tregon se formimi teknik kompjuterik, edhe pse i pranishëm, nuk është bërthama e programit — ai është njëra nga dy shtylla të një diplome ndërdisiplinare, e cila synon formimin e specialistëve të informatikës së aplikuar në biznes, jo të inxhinierëve ose shkencëtarëve kompjuterikë.

Klasifikimi zyrtar institucional pasqyron këtë orientim: diploma lëshohet nga **Fakulteti i Ekonomisë**, jo nga një fakultet i shkencave kompjuterike ose inxhinierisë, apo rëndom edhe nga fakulteti i shkencave të natyrës(UT). Ky klasifikim nuk është thjesht administrativ — ai pasqyron vendimin e vetë institucionit akademik se çfarë lloj profesionisti formon programi. Rrjedhimisht, programi “Informatikë Ekonomike”, pavarësisht prezencës së lëndëve IT, **nuk përputhet me klasifikimin akademik dhe thellësinë e formimit teknik** të kërkuar nga DT. **Kriteri i diplomës: NUK PLOTËSOHET.**

Lidhur me Përvojën 5-vjeçare në .NET + SQL Server

Eksperti teknik konstaton se z. Çollaku është i punësuar me kohë të plotë si **Softëare Architect @ Helius Systems** prej datës **16.07.2017 deri aktualisht** — mbi 7 vite e 8 muaj me vazhdimësi të pandërprerë. Kontrata individuale e punës e datës 01/07/2018 konfirmon pozicionin “**Zhvillues në Teknologji Informacioni**” me kohë të plotë dhe pa afat të caktuar. Teknologjitë e konfirmuara shprehimisht në CV: ASP.NET MVC 5, .NET Core, Services SOAP dhe REST API, C# (CSLA), SQL Server, Elastic Search, RabbitMQ, Redis, Hangfire. **Kriteri i përvojës: PLOTËSOHET.**

Lidhur me Projektet e Natyrës së Ngjashme (.NET + SQL Server)

CV-ja e z. Çollaku liston njëmbëdhjetë projekte konkrete të zhvilluara si Software Architect, me ASP.NET MVC 5, .NET Core dhe SQL Server si teknologji kryesore. Drejtpërdrejt relevante me natyrën e sistemit e-pasuria të tenderit përfshijnë: Migrimi i sistemit Eterna Financiare nga desktop në web (ASP.NET MVC + SQL, më shumicë se 15 shërbime pagese); Eterna Postar System (ASP.NET MVC + SQL); SLDB Core Banking System dhe KRK Core Banking System (sisteme të integruara bankare në .NET + SQL Server); E-Posta Mobile Application (backend .NET Core + REST API); Eterna Fiscalization Module. Letra e referencës (23.01.2026) konfirmon gjithashtu pjesëmarrjen në Platformën Kombëtare e-Albania, Sistemin NISA dhe Crimson Albania — Core Banking System — të tria me .NET dhe SQL Server si teknologji kryesore. **Kriteri i projekteve: PLOTËSOHET.**

Lidhur me Certifikimet Microsoft

<u>Certifikimi</u>	<u>Nr. Certifikatës</u>	<u>Fituar</u>	<u>Skadon</u>	<u>Statusi</u>
Microsoft Certified: Azure Developer Associate (AZ-204)	6E5F8A-C34F3X	07.07.2025	08.07.2026	<u>Aktiv</u>
Microsoft Certified: DevOps Engineer Expert (AZ-400)	EFP455-FD5E7F	14.07.2025	15.07.2026	<u>Aktiv</u>
Microsoft Certified: Azure AI Engineer Associate (AI-102)	785W99-0B8C2C	23.07.2025	24.07.2026	<u>Aktiv</u>

Të gjitha certifikimet janë të verifikueshme online (username: Marinollaku-9649) dhe brenda afatit të vlefshmërisë. Certifikimi Azure Developer Associate (AZ-204), i fituar nëpërmjet provimit “Developing Solutions for Microsoft Azure”, konfirmon kompetencë aktuale në zhvillimin e aplikacioneve .NET në platformën Microsoft — drejtpërdrejt relevant me DT-në. **Kriteri i certifikimeve: PLOTËSOHET.**

Konkluzion 2.B: Pretendimi ankimor i OE ankues kundrejt vendimit të AK lidhur me skualifikimin e Zhvilluesit 2 z. Marin Çollaku, në aspektin teknik të kriterit të diplomës, **ËSHTË I PABAZUAR:** programi “Informatikë Ekonomike” nuk përputhet me klasifikimin akademik dhe thellësinë e formimit teknik të kërkuar nga DT.

- **Konstatimi i ekspertit për pretendimin ankimor 2.C**

Kërkesa e Dosjes së Tenderit (DT)

Eksperti teknik sqaron se lidhur me kriteret profesionale në DT për pozicionin **Analist i Sistemit (1 zyrtar)**, është kërkuar:

- Diplomë Universitare Inxhinier i Kompjuterikes me telekomunikacion OSE Master i Shkencave Kompjuterike OSE Master Inxhinierisë Kompjuterike;
- Minimum 5 vite përvojë pune si analist në se paku tre projekte të natyrës së ngjashme të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server);
- Dëshmi: Diplomë (kopje), Kontratë punës valide (kopje), Letër reference (kopje), CV.

Eksperti teknik, duke analizuar kërkesat e DT dhe dokumentacionin e ofruar nga OE ankues në dosjen e tenderit, duke u bazuar gjithashtu në literaturën profesionale ndërkombëtare mbi rolin e Analistit të Sistemit, thekson se:

Lidhur me Diplomën

OE ankues ka paraqitur dokumentacion akademik të nivelit të lartë dhe plotësisht të qartë: **(i)** Bachelor dhe Master i Shkencave në Informatikë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, UT, 1997–2002; **(ii)** Master i Nivelit të Dytë në Shkenca Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, UT, 2003–2006, fusha TIK, teza: “Implementation of Network Security through Firewall Appliance Integration”; **(iii)** PhD i Shkencave, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, UT, 2010–2016, fusha TIK, teza: “Development of a security plan for the protection of critical/sensitive information and business processes”; dhe **(iv)** titull akademik Prof. Asoc. Dr., Universiteti i Tiranës, 2016–2022. Të gjitha diplomat lëshohen nga **Fakulteti i Shkencave të Natyrës** program i dedikuar teknik kompjuterik, me tituj të qartë “Informatikë” dhe “Shkenca Kompjuterike”. Kriteri i DT-së për diplomë **PLOTËSOHET**

Roli i Analistit të Sistemit — Analizë Konceptuale

Eksperti teknik thekson se bazuar në praktikën dhe literaturën profesionale ndërkombëtare mbi rolin e Analistit të Sistemit në kontekstin e projekteve IT, me qëllim të vlerësimit objektiv të dokumentacionit të paraqitur. Analisti i Sistemit është profesionist IT i cili specializohet në analizimin, projektimin dhe implementimin e sistemeve të informacionit — duke shërbyer si lidhja kritike midis objektivave të biznesit dhe zgjidhjeve

Funksionet kryesore të Analistit të Sistemit (i quajtur edhe Systems Analyst, Product Analyst ose Functional Analyst) ndryshojnë qartë nga ato të Project Manager: analisti fokusohet në nevojat e biznesit, kërkesat dhe qartësinë e zgjidhjes — ndërsa menaxheri i projektit fokusohet në planifikimin, koordinimin, dorëzimin, rrezikun dhe menaxhimin e burimeve. (<https://www.staffing-maker.com/assets/data/blogpage/ba-vs-pm-business-analyst-vs-project-manager-roles-skills-differences-1769204537> data qasjes 10.04.2026)

Analistit i Sistemit është person teknik që merret me mjedisin teknik ekzistues të organizatës, themelin teknologjik të sistemit të ri dhe mënyrën se si të dyja mund të integrohen në një zgjidhje teknike. Nga ana tjetër, menaxheri i projektit merret me plotësimin e projektit brenda afatit dhe buxhetit. Në disa raste, menaxheri i projektit është shpesh një analist i sistemit me

përvojë, i cili nëpërmjet trajnimit ka fituar njohuri të specializuara të menaxhimit të projekteve (https://www.researchgate.net/post/what_are_integration_and_differences_between_system_analyst_and_project_manager_data_gasjes_10.04.2026), këto dallime konceptuale janë vendimtare për vlerësimin e dokumentacionit të z. Mulla.

Lidhur me Kronologjinë e Karrierës — Analizë në raport me rolin e Analistit

Duke analizuar CV-në Europass të paraqitur sipas periudhave kronologjike, eksperti teknik konstaton:

Nga kronologjia e plotë e karrierës rezulton se **asnjë rol i dokumentuar në CV nuk emërton shprehimisht pozicionin “Analist i Sistemit”** — as si titull formal, as si funksion kryesor i dokumentuar për ndonjë periudhë specifike. Karriera e z. Mulla dokumenton me qartësi tre profile profesionale të dallueshme: **Project Manager, IT Security/Governance Expert dhe Akademik** — të gjitha me vlerë të lartë profesionale, por asnjëra nuk korrespondon drejtpërdrejt me profilin e kërkuar nga DT.

Lidhur me Letrën e Referencës dhe Pretendimin e OE

OE ankues mbështetet kryesisht në Letrën e Referencës të datës 23.01.2026 të lëshuar nga Helius Systems, e cila e cilëson z. Mulla si “Project Manager dhe System Analyst” njëkohësisht. Eksperti teknik vëren dy aspekte kritike lidhur me këtë letër:

Së pari — Kombinimi i titujve “Project Manager dhe System Analyst” në të njëjtën letër reference pasqyron një realitet të njohur në industrinë IT, ku sidomos në kompanitë e madhësisë mesatare, të njëjtit profesionistë shpesh mbulojnë funksione nga të dyja rolet ([https://ëëë.researchgate.net/post/ëhat_are_integration_and_differences_betëëeen_system_analyst_and_project_manager](https://ëëë.researchgate.net/post/ëhat_are_integration_and_differences_betëëeen_system_analyst_and_project_manager_gasja_09.04.2026), qasja: 09.04.2026). Kjo mbivendosje, megjithëse e zakonshme në praktikë, nuk zëvendëson kërkesën e DT-së për 5 vite përvojë të dokumentueshme si analist, jo si menaxher projekti.

Së dyti — Letra e referencës është lëshuar nga **i njëjti punëdhënës që ka paraqitur ofertën — Helius Systems sh.p.k** — organizata ankuese. Funksionet e SA të përshkruara në letër — analizë kërkesash, projektim arkitekturash — janë funksione që sipas profilit akademik z. Mulla padyshim i zotëron; por mungesa e dokumentimit të rolit të SA nëpërmjet një kontrate punës të pavarur ose reference të jashtme e dobëson dëshmisë e paraqitur.

Lidhur me Certifikimet

Konkluzion 2.C: Pretendimi ankimor i OE ankues kundrejt vendimit të AK lidhur me skualifikimin e Analistit të Sistemit z. Gjergji Mulla **ËSHTË I PABAZUAR**

Portfolio-ja e certifikimeve aktive konfirmon dhe forcon profilin e z. Mulla si **ekspert i nivelit të lartë në IT Governance, Menaxhim Rreziku, Auditim dhe Menaxhim Projektesh**. Megjithatë, asnjë certifikim aktiv nuk ka lidhje me zhvillimin ose analizën teknike të aplikacioneve .NET + SQL Server të kërkuar nga DT. Certifikim et tipike për rolin e System Analyst përfshijnë CSAP, CBAP, PMP dhe Microsoft Azure (<https://www.springboard.com/blog/software-engineering/become-systems-analyst/>, qasja: 09.04.2026) — asnjë nga këto nuk është e pranishme. Certifikimi i vetëm Microsoft i paraqitur

(MCP 2002, Windows 2000) është i skaduar dhe fituar 23 vite para datës së ofertës. **Kriteri i certifikimeve: NUK PLOTËSOHET.**

Eksperti shqyrtues, sqaron se përveç arsyeve të eliminimit të OE ankues, për të cilat ka dhënë përgjigje eksperti Teknik, autoriteti kontraktues, e anulon në tërësi aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se:

Eksperti shqyrtues, vlerëson se sipas dispozitave të Nenit 62 të LPP-se, një situatë e tillë nuk parashihet në dispozitat e nenit 62 të LPP-se, dhe rrjedhimisht qëndron pretendimi i OE ankues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “Helius System” Sh.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Helius System” Sh.P.K, janë të pabazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuar nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara, të paraqitura ndaj vendimit të autoritetit kontraktues, për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli shqyrtues i ka falur pjesërishtë besimin konstatimit në raportin e ekspertit shqyrtues, pasi që vrehet se autoriteti kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme, në arsyetimin e vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit ka theksuar se si ne vijim;

” Pas inicimit të kësaj procedure, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 02/02 të datës 20.02.2026 për riorganizimin institucional, është bërë ndarja e ministrisë, ku si rezultat janë krijuar struktura të reja institucionale. Si pasojë e këtij riorganizimi institucional është bërë edhe ndarja e buxhetit përkatës ndërmjet institucioneve të reja.

Për shkak të këtij ndryshimi, Autoriteti Kontraktues aktualisht nuk disponon mjetet e nevojshme buxhetore për realizimin e kësaj procedure të prokurimit, pasi buxheti i planifikuar për këtë aktivitet është ndarë sipas strukturës së re institucionale.

Duke u bazuar në këto rrethana dhe në pamundësinë për të siguruar financimin e kontratës, Autoriteti Kontraktues anulon procedurën e prokurimit, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore të nevojshme për realizimin e saj.”

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimit ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht si e bazuar, pasi që anulimit të aktivitetit të prokurimit, Operatori ekonomik ankues, nuk i ka kontribuar me ndonjë veprim, që do të ishte përgjegjës për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe OE nuk duhet të dëmtohet financiarisht në këtë aktivitet të prokurimit, andaj dhe i kthet tarifa e ankesës në shumën e paguar, për kunder bazës ligjore për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të aprovuar pjesërisht ankesën e OE “Helius System” Sh.P.K, dhe mbet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës 11.03.2026, AK/ Ministria e Punëve të Brendshme, me të cilin ka anuluar aktivitetin e prokurimit, “Mirëmbajtja dhe përkrahja e sistemit e-pasuria”, me numër të prokurimit 214-25-11241-2-1-1.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlerësimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2026/0200, se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar, dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjeserishëm të ankesës të OE "Helius System" Sh.P.K, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - HELIUS SYSTEM sh.p.k**
- Arkivës së OSHP-së: